

DK/DMP

03-4391/12

01

07.12.2012

Shifra :0499 RI.nr.11526/12

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË FERIZAJ, gjyqtarja Hysnije Gashi me sekretaren juridike Imrane Shabani, duke vendosur ne proceduren kundervajtese kunder te pandehures, Qazime Vata nga Ferizaj ,për shkak të kundërvajtjes nga neni 5.6 par.1.3 dhe neni 17 par 1.3 të Ligjit për Deklarimin e Prejardhjen dhe Kontrollin e Paurise se zyrtareve te larte publik dhe deklarimin dhe prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat zyrtar(Ligji nr.04/L050), në bazë të neneve 198 al.1 pika 10 të LK 31,73 , 195 të Ligjit mbi Kundërvajtjet me datë 29.11.2012 merr këtë:

A K T V E N D I M

Duke u bazuar ne Kerkesen-shkresen e Agjencionit Kunder Korrupcionit me numer te protokollit nr. 02814 te dates 07.08.2012, konform neni 198 paragrafi 10 te Ligjit per Kundervajte:

PEZULLOHET procedura kundërvajtëse kundër të pandehures Qazime Vata -Drejtore dhe Drejtorise se Urbanizmit, Prones, Kadastrit, Gjeodezise dhe Mbrojtjes se Mjedisit ne Ferizaj, Nga një ekzemplar i këtij aktvendimi u dërgohet palëve.

A r s y e t i m i

Agjencioni kunder Korrupcionit ne Prishtine, ka parashtruar kerkesen nr.2225/2012 te dates 15.06.2012 per fillimin e procedures kundrvajtese ndaj Zyrtares se larte publike Qazime Vata Drejtore dhe Drejtorise se Urbanizmie, Prones, Kadastrit, Gjeodezise dhe Mjedisit ne Ferizaj, pasi si zyrtare e lart publike nuk e ka plotsuar formularin per deklarimin dhe prejardhjen e pasurise ne afatin, e parapare ligjor.

Gjyqtarja filloi proceduren kundërvajtëse duke u bazuar ne Kerkesen e Agjencise Kunder Korrupcionit, me te cilen kerkeseshkrese Z. Preteni ka kerkuar qe te pezullohet procedura kundevajtese e filluar ndaj te pandehures e dates 15.06.2012 ne nr.2226, per shkak se ne kete rast eshte bere nje leshim teknik me c rast e pandehura nuk eshte shlyer nga lista e zyrtareve te larte publik qe e ka deklaruar pasurine. Kjo deshmohet me faktin se bashkangjitur ne kete kerkeseshkrese eshte prezentuar Kopja e vertetimit per deklarimin e pasurise e dates 27.03.2012.

Në bazë të dhënave të përmendura më lartë u konstatua se janë plotësuar kushtet për PEZULLIMIN e procedures kundërvajtëse, në vështrim të neni 198 al.1 pika 10 LK, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Vendosur në Gjykatën komunale për kundërvajtje në Ferizaj, me datën 29.11.2012.

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankese Gjykatës së Lartë për kundërvajtje në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, përmes kësaj Gjykate, pa pagesë takse.

Sek.juridike
Imrane Shabani

Gjyqtari,
Hysnije Gashi